



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština – Assembly*

---

**Legjislatura VIII**  
**Sesioni pranveror**

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike  
Mbledhja nr. 104  
Prishtinë, më 2.7.2024, në orën 11:00  
Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-303

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Hykmete Bajrami, Arta Bajralija, Bekim Arifi, Yllëza Hoti, Halil Thaçi, Mirlinda Tishukaj-Sadiku, Albana Bytyçi, Rashit Qalaj dhe Hajdar Beqa.

**Munguan:** Visar Korencia dhe Adem Hoxha.

**Stafi mbështetës i Komisionit:** Antigona Ibraj.

**Pjesëmarrësit tjerë:** Arbërie Nagavci, Taulant Kelmendi, Fatmir Elezi dhe Shpresa Kokollari nga MASHT; Myrvete Gashi- Morina, Samir Zymberi dhe Driada Thaçi, nga ZKA; Bekim Gashi, GP-LVV; Majlinda Ibrahimimi- KTV.

**Mbledhjen e kryesoi:** Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i raportit të auditimit të performancës: “Modernizimi i sistemit të edukimit në Kosovë përmes e-Edukimit”.
3. Të ndryshme.

**1. Miratimi i rendit të ditës**

*Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

#### 4. Shqyrtimi i raportit të auditimit të performancës: “Modernizimi i sistemit të edukimit në Kosovë përmes e-Edukimit”.

**Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit:** Të nderuar, ne e kemi të caktuar sot raportin e auditimit: “Modernizimi i sistemit të edukimit në Kosovë përmes e-Edukimit”. Për ta shqyrtuar këtë raport, të ftuar dhe prezent e kemi ministren e MASHTI, znj. Arbërie Nagavci. Ky raport ka rezultuar me disa gjetje, andaj për t’i shpalosur gjetjet në këtë raport, si komision, kemi caktuar deputete raportuese, deputeten Mirlinda Tishukaj- Sadiku, andaj edhe ia kaloj fjalën.

**Mirlinda Tishukaj- Sadiku:** Si deputete raportuese, do t’i paraqes gjetjet, të cilat i ka identifikuar ZKA, për këtë raport. Zyra Kombëtare e Auditimit ka kryer raportin e auditimit të teknologjisë së informacionit, është bërë për të vlerësuar nëse MASHTI ka menaxhuar dhe zbatuar projektin e teknologjisë së informacionit: “Modernizimi i sistemit të edukimit në Kosovë përmes e-Edukimit”, në mënyrë efektive për të përmbushur objektivat e këtij projekti dhe qëllimin e ministrisë për digjitalizimin e procesit mësimor dhe të testimit/vlerësimit të maturës. Auditimi ka mbuluar periudhën nga viti 2013 deri në vitin 2023. Gjetjet janë: ***MASHTI, në vitin 2013, pa ndonjë analizë dhe planifikim paraprak, ka nënshkruar marrëveshjen për zhvillimin e projektit përmes procesit të huamarrjes.*** MASHTI nuk ka një dokument planifikimi paraprak për të zhvilluar një projekt të TI-së për digjitalizimin e sistemit të edukimit në arsimin parauniversitar të Kosovës, të cilin do të duhej ta kishte hartuar para nënshkrimit të marrëveshjes për zhvillimin e projektit në vitin 2013. Në “Strategjinë për zhvillimin e arsimit parauniversitar në Kosovë 2007–2017” nuk është theksuar nevoja për zhvillimin e një projekti të tillë. Po ashtu, as në “Kornizën e kurrikulës së arsimit parauniversitar të vitit 2011” dhe atë të rishikuar më vonë në vitin 2016. Pra, është zhvilluar një projekt me vlerë 4,931,000 euro, pa ndonjë planifikim të duhur dhe me mangësi gjatë zhvillimit të projektit që kanë ndikuar në mosarritjen e qëllimit dhe përmbushjes së misionit të organizatës, për digjitalizimin e arsimit parauniversitar. ***-MASHTI nuk ka siguruar infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e projektit.*** Në kohën e zhvillimit të projektit nuk kishte infrastrukturë bazike për përdorimin e sistemit nëpër shkolla. Andaj, sistemi i zhvilluar nuk ka arritur të zbatohet në shkolla, duke mos pasur pajisje dhe rrjet për t’u qasur përdoruesit. MASHTI nuk arritur të realizojë/sigurojë përgatitjet e nevojshme teknike sipas marrëveshjes, që t’i mundësojë OE-së të instalojë softuerin. MASHTI, gjatë kohës së zhvillimit të projektit, në fazat testuese ka përdorur infrastrukturën që ka ekzistuar në disa prej shkollave. Mirëpo, ajo infrastrukturë ka rezultuar të jetë e pamjaftueshme, prandaj nuk ka vazhduar të përdoret edhe pas zhvillimit të projektit. ***- MASHTI nuk ka menaxhuar dhe monitoruar mirë projektin për digjitalizimin e arsimit parauniversitar.*** MASHTI nuk ka përgatitur një raport përfundimtar për realizimin e projektit. Pas çdo faze të projektit, komisionet e pranimit kishin përgatitur raporte për realizimin e projektit. Raportet e komisioneve të pranimit nga ana e MASHTI ishin të mangëta dhe më pak informacion mbi ato që kanë pranuar në raport me specifikat teknike. Për pranimin e fundit, MASHTI ka kërkuar nga komisioni i pranimit që të raportojë pas realizimit të pagesës, megjithatë komisioni kishte vlerësuar se OE nuk ka realizuar punën sipas kërkesës dhe disa prej anëtarëve të komisionit edhe nuk kanë nënshkruar raportin. MASHTI nuk ka reaguar në periudhën e paraparë në marrëveshje për aprovim apo mos-aprovim të procesimit të pagesës, dhe sipas kësaj, pas kalimit të afatit, heshtja konsiderohet aprovim. MASHTI nuk ka menaxhuar mirë as sigurimin e cilësisë për këtë projekt. Koordinatori për pjesën e e-Maturës ka kërkuar që të bëhet auditim për projektin që bazohej edhe në marrëveshjen e lidhur MASHTI me OE-në, por kjo nuk ishte bërë.

Si pasojë e menaxhimit të tillë, ky projekt nuk është raportuar në Qeveri apo MF, që ka përfunduar realizimi, mirëpo është raportuar i papërfunduar, si dhe pagesa e fundit e procesuar në vlerë të 547,400 euro, nuk është regjistruar në SIMFK. ***Mungesa e qasjes në sistem dhe mungesa e dokumentacionit/informacionit të nevojshëm për auditim, që ndikon në fushëveprimin e auditimit.*** MASHTI nuk ka bërë administrimin e duhur të këtyre dokumenteve dhe nuk ka arritur të sigurojë informacionin dhe të gjitha vendimet për grupet punuese, komisionet dhe koordinatorët e këtij projekti. Për më tepër, gjatë periudhës së zhvillimit të projektit, në disa nga raportet e komisioneve të pranimit, është cekur se mungonin dokumentet bazë për vlerësim, siç është kontrata dhe specifikat teknike që i nevojiteshin komisionit për të vlerësuar pranimin. - ***Zbatimi i marrëveshjes mes MASHTI dhe OE ka mangësi.*** OE-ja, pas përfundimit të modulit "e-Learning", ka dorëzuar në MASHTI kodin burimor për këtë pjesë, pastaj më vonë ai ka dorëzuar kodin burimor edhe për pjesën "e-Matura". OE-ja, për këtë, ka përgatitur një raport përfundimtar. Mirëpo, MASHTI nga komisioni i pranimit, ka marrë një raport të panënshkruar nga të gjithë anëtarët e komisionit, për të ka pasur edhe disa vërejtje. Pavarësisht nga kjo, pagesa është realizuar për komplet projektin, para se të përgatitej ky raport nga komisioni i pranimit, pasi që është përmbushur neni i marrëveshjes për aprovim në heshtje. - ***Kërkesat e sigurisë së informacionit në marrëveshjen e MASHTI-t dhe OE-së nuk janë adresuar.*** MASHTI, për modernizimin e sistemit të edukimit në Kosovë, nuk ka arritur të adresoj çështjet e sigurisë sipas kontratës lidhur me obligimin e konfidencialitetit për palët që kanë qasje në sistem.

Gjatë viteve 2013-2017, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, ka zhvilluar projektin për digjitalizimin e arsimit parauniversitar në Kosovë, në vlerë prej 4,931,000 euro. Për zhvillimin e këtij projekti, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, ka negociuar marrëveshjen për kredi të butë, përmes bankës austriake UniCredit Bank Austria dhe Qeverisë austriake, si garantues, e cila është ratifikuar në Kuvendin e Kosovës në vitin 2014 dhe do të paguhet deri më 30 shtator 2032, në një vlerë totale 5,637,519 euro (përfshirë kryegjënë, interesin, tarifat). Me zhvillimin e këtij projekti do të krijohet sistemi me dy module, për komponentin e mësimin elektronik dhe komponentin e digjitalizimit të provimit të maturës, si dhe serverët për vendosjen e sistemit të zhvilluar. Mirëpo, projekti në fjalë nuk është funksionalizuar dhe nuk janë arritur qëllimet e këtij projekti për e-edukimin dhe digjitalizimin e provimit të maturës. Për këtë raport, ZKA ka dhënë 14 rekomandime për Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit. Një nga zërat e digjitalizimit të provimit të maturës kam qenë edhe unë. Këto janë taksa të qytetarëve që po paguhet për këtë projekt dhe si ka pasur mundësi të mos ketë një marrëveshje të tillë të qartë. Ministre, në strategjinë e arsimit e ke paraparë që në të ardhmen, të bëhet edhe digjitalizimi i shkollave, andaj me gjithë këto probleme të trashëguara, çka do të ndodhë me këtë marrëveshje, si do të adresohet? Si shoqëri, nuk mund të mbesim peng, sepse Kosova ka obligim t'i kryejë pagat. Prandaj, për mua është e papranueshme që si vend të hyjmë në obligim për një marrëveshje të dështuar. A e keni dërguar këtë rast në prokurori, sepse konsideroj që të gjithë personat e përfshirë në këtë proces kanë emër dhe mbiemër dhe duhet të jenë përgjegjës për këtë projekt.

**Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit:** Ministre, ju e dëgjuat përmbledhjen dhe besoj që edhe para këtij raporti, ju e keni kuptuar gjendjen. Në kohën e pandemisë, kur kam qenë ministre,

përfaqësuesi i “Bit Kosova”, që është edhe partner i “Bit Austria”, pati dalë në rrjete sociale dhe pati thënë që ministria është e gatshme të bëjë mësimin online, për shkak se ekziston një projekt i tillë. Unë kam pasur fatin të jem ministre e Arsimit dhe kur e kam kërkuar si projekt, e kam pa që ende nuk është bërë dorëzimi i kodeve burimore. Andaj, unë kisha kërkuar që ju si ministre, të na përgjigjeni se çka është bërë që tri vite rreth adresimit të kësaj çështjeje. Po ashtu kam pyetje edhe për ZKA-në, e cila në njëfarë mënyre, komplet përgjegjësinë e vë te ministri i Arsimit, ndërkohë nuk ka vënë asnjë përgjegjësi tek operatori ekonomik, as ai vendor e as ai ndërkombëtar. Në atë periudhë të shkurtër sa kam qenë aty ministre, ka pasur edhe një dosje dhe ajo që më intereson ta di është se a po vazhdon faza e dytë e projektit me “Bit Austrinë”. Sepse ka qenë edhe një projekt tjetër 5 milionë, të cilin unë kam refuzuar për ta nënshkruar. A ka projekt të tanishëm? Për ZKA-në, raporti nuk ka një zinxhir të përgjegjësisë, sepse sa kam pasur informacione unë, për këtë projekt ka pasur herë pas here koordinator, sepse askush fort nuk ka pranuar ta marrë përgjegjësinë. Prandaj, edhe nuk ka pasur një raport të nënshkruar për dorëzim teknik, sepse personat përgjegjës kanë refuzuar ta nënshkruajnë si të tillë e ndërkohë janë kryer pagesat që kjo për mua është e paqartë.

**Arbërie Nagavci, ministre e MASHTI:** Ky projekt, sa unë jam në njohuri, është i pa- precedent. Pra, bëhet fjalë për 5,637,519 euro, për të cilat nuk kemi asnjë produkt të vetëm. Po flasim për një projekt 2013-2017. Në atë kohë, MASHT kishte zhvilluar këtë projekt dhe MF kishte negociuar marrëveshje për kredi të butë, përmes Bankës UniCredit Bank Austria dhe e njëjta marrëveshje është ratifikuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës, në vitin 2014. Pas pranimin të mandatit, kam kërkuar që ky projekt të auditohet. Nga ish-sekretari, z. Agim Berdyna, kam kërkuar që të na ofrojë të gjitha materialet në dispozicion. Kanë qenë një grumbull dokumentesh, që kanë pasur të bëjnë më shumë me trajnime me stafin e mësimdhënësve në shkolla të ndryshme të Kosovës, por pasi nuk ka pasur asnjë produkt më tepër, unë kam kërkuar auditim nga auditori i brendshëm i MASHTI. Ata kanë filluar auditimin dhe kanë parë që ka mungesë të resurseve dhe kompletimit të dokumentacionit, dhe duke e parë që ka qenë e pamundur, është ngritur si çështje dhe është audituar nga ZKA-ja. Duhet ta theksoj, se përveç faktit që ky projekt ka filluar, pa asnjë vlerësim pa asnjë strategji, duhet ta theksoj se që nga fillimi e deri te marrja e mandatit tim, kam parë që MASHTI, nuk ka pasur as departament për digjitalizim, e as zyrtar kompetent që mund të ishin të involvuar në këtë proces. Po ashtu kemi kërkuar ta shohim a është sistemi funksional dhe krejt çka kemi gjetur është një dokument i datës 18.3.2020, i cili konfirmon dorëzim-pranimin e kredencialeve për dorëzimin e platformës për mësimin online, e-edukimi. Në atë dokument thuhet se përfaqësuesi i kompanisë, me kërkesë të ministres Bajrami, e bën dorëzimin e kredencialeve. Përtej kësaj, nuk kemi gjetur asgjë konkrete. Kemi kontaktuar me ASHI-në, që të shohim nëse ky sistem është funksional dhe kemi kuptuar që nuk është funksional, andaj edhe kemi pritur raportin e ZKA-së. Sot, me mua është edhe z. Fatmir Elezi, udhëheqës i Divizionit për Vlerësim dhe Standard, i cili ka qenë, pak më shumë përgjegjës për pjesën e e-maturës dhe i cili ka qenë njëri nga ata që ka shprehur shqetësimet e tij dhe nuk e ka nënshkruar raportin për këtë projekt. Përkundër mungesës së dokumenteve, krejt çka kemi pasur në dispozicion, ia kemi ofruar ZKA-së, andaj edhe unë jam pajtuar me gjetjet. Posa e kemi pranuar raportin, këtë çështje e kemi

dorëzuar në Prokurorin Speciale, bashkë me të gjitha dokumentet që kemi pasur në dispozicion dhe jemi njoftuar që është duke u punuar në këtë drejtim dhe prokuroria ka kërkuar informata shtesë, për këtë rast.

**Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit:** Vetëm për sqarim. Pranimi i kredencialeve nënkupton marrjen e kodeve burimore. Në atë kohë, kur u bë mbyllja e shkollave për shkak të pandemisë, ka qarkulluar se MASHTI e ka sistemin e gatshëm për mësimin online, andaj kam kërkuar sqarime dhe jam njoftuar se ende nuk i kanë as kodet burimore. Por, ajo nuk nënkupton pranimin e projektit, por thjesht kam kërkuar kodet burimore që të kemi qasje për të punuar. Por ajo që kisha dashur ta di, pasi qenka edhe z. Elezi këtu, është se çka ka ndodhur me fazën e dytë të projektit, a ka vazhduar apo jo?

**Arbërie Nagavci, ministre MASHTI:** Pasi kemi edhe media, dua t'i kemi të qarta detajet. Projekti ka filluar në vitin 2013-2017. Ministër ka qenë z. Ramë Buja. Kurse, në dokumentin që e përmenda, thuhet që është bërë dorëzimi i kredencialeve për administrimin e platformës e-edukimi. Në lidhje me pyetjen tjetër, në kohën sa jam ministre unë, nuk është bërë asnjë pagesë, pagesat janë bërë paraprakisht. Siç ka thënë edhe ZKA, një pagesë e papërfunduar në vlerën mbi 500 mijë euro, është paguar nga MF-ja. Kam pasur kërkesa për disa takime nga përfaqësuesit e Bit Austria, është kërkuar të iniciohet një projekt i ri dhe kanë thënë që është gjithçka e gatshme në marrjen e një kredie tjetër, të cilën natyrisht si ministre nuk e kam marrë parasysh, nuk ka projekt të ri për t'u vazhduar, duke e pasur parasysh gjendjen e projektit paraprak se qysh e kemi gjetur.

**Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit:** Prapë po e theksoj se kredencialet janë vetëm qasje në sistem, nuk ka qenë dorëzim-pranim i projektit. E dyta, pyeta për fazën e dytë, sepse edhe unë kam refuzuar që ta bëj. Ajo që më intereson tani ta di, është se a ka mundësi që një pako e tillë softuerike, të shfrytëzohet dhe të futet në përdorim, apo thjesht ai program, nuk do të shfrytëzohet asnjëherë, sepse tashmë ka ndërruar edhe teknologjia. Apo mund të konkludojmë se ai sistem nuk do të hyjë në funksion asnjëherë, pavarësisht përpjekjes së ministrisë për të krijuar infrastrukturën e nevojshme.

**Arbërie Nagavci, ministre MASHTI:** Sistemi, me aq sa kemi mundur ne ta konstatojmë, është jofunksional. E theksova, se kur e kam marrë mandatin, kam kërkuar dokumentacionin, kam pritur raportin e auditimit, i cili po ashtu e konstaton që ai sistem është jofunksional dhe më pas e kam dërguar lëndën në Prokurori Speciale. Andaj, s'mund të kemi konstatim, sepse sistemi është jofunksional.

**Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit:** Raporti i ZKA-së, thotë se kinse arsyet pse ka dështuar, për shkak se ministria nuk i ka krijuar kushtet harduerike, për këtë e kisha pyetjen, andaj edhe e pyeta edhe ZKA-në, pse ka pasur një koncentrim vetëm te ministria dhe jo edhe tek operatori? Andaj, pyeta se a ka ndonjë mundësi që personat përgjegjës dhe ministria ishte dashur të diskutojnë me operatorin, të cilit iu kanë paguar paratë, për të diskutuar se a mund të funksionalizohet një sistem i tillë, apo po pritet nga prokuroria që ta bëjë një gjë të tillë?

**Mirlinda Tishukaj- Sadiku:** Kryetare, a po i referoheni të kaluarës a të tashmes?

**Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit:** Jo, po i referohemi gjendjes aktuale. Sepse të gjithë po pajtohemi se ka qenë një projekt skandaloz, sepse është krijuar një softuer pa pasur infrastrukturë paraprake. Është krijuar një digjitalizim nga kulmi, pa i pasur muret dhe bazën fillestare. Andaj, tani pyes, sa është mundësia se në qoftë se krijohen kushtet, ky sistem të funksionalizohet?

**Taulant Kelmendi, MSHTI:** Kryetarja ka qenë edhe ministre. Ministria e ka edhe emrin për teknologji dhe inovacion, por nuk ka pasur asnjë departament, asnjë person që është marrë me teknologji dhe inovacion në arsim. Nga ana tjetër, ish-ministrja Hykmete Bajrami, me të drejtë ka kërkuar qasje në këtë sistem. Andaj, sistemi është deponuar te Zyra e Ministres, pikërisht se nuk ka pasur një departament fare.

**Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit:** Te Zyra e Sekretarit, jo Ministres.

**Taulant Kelmendi, MSHTI:** Unë po i referohem dokumentit, sido që të jetë, ju me siguri keni qenë në dijeni. Por, ne nuk jemi në dijeni çka ka ndodhur më tutje, andaj pavarësisht vullnetit tonë për të hyrë në një sistem që është nisur para më shumë se një dekadë dhe duke parë zhvillimet teknologjike, aludojmë që është jofunksional. I kemi parë edhe serverët, me kërkesë në SHI, janë jofunksional, ka edhe mungesë të resurseve, andaj konsiderojmë që është jo- funksional. Pra, kemi të bëjmë me një projekt 5.6 milionë euro, i cili është avulluar, me para të taksapaguesve të këtij vendi.

**Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit:** Unë tregova që jam informuar nga rrjetet sociale, andaj kam kërkuar që ta shoh sistemin, jam informuar edhe prej DKA-së së asaj kohe, në Prishtinë, se janë trajnuar disa mësimdhënës. Kemi hyrë në sistem dhe e kemi parë që nuk ka asnjë material, andaj jemi detyruar për të punuar në kohën e pandemisë, diçka prej fillimit. Andaj, edhe pyeta ZKA, pse fokusi është vetëm te ministrja, sepse janë punë që është dashur të bëhen njëkohësisht. Unë kisha dashur ta di, se çka ka punuar ministria, sa i përket digjitalizimit në këto 3 vitet e fundit?

**Arbërie Nagavci, ministre MASHTI:** Nëse po flasim çka është bërë për digjitalizimin jashtë këtij projekti. Ne kemi filluar një proces gjithëpërfshirës dhe kemi aprovuar Strategjinë për arsimin dhe shtylla e 5-të ka të bëjë me digjitalizimin, pikërisht për të mosvepruar, siç ka qenë pa analiza paraprake. Unë kisha pyetur, sa keni qenë ministre, a e keni verifikuar se a ka qenë ai sistem funksional apo jo, sepse kjo na ndihmon?

**Hykmete Bajrami, kryetare e komisionit:** Siç e thashë, kemi kërkuar për t'u qasur dhe kemi hyrë dhe e kemi parë që është jofunksional. Drejtori që e keni këtu, ka qenë edhe atëherë dhe na ka thënë që përpos disa CD-ve nuk kemi asgjë tjetër, prandaj edhe nuk ka pranuar ta nënshkruaj raportin. Ka qenë kohë e pandemisë, është punuar me staf të reduktuar Por, për aq muaj sa isha ministre në kohë pandemie, nuk kam pasur mundësi për të krijuar harduer. Andaj, edhe ju pyeta nëse më pas janë bërë përpjekje për të përgatitur pjesën harduerike për projektin. Në kohën sa kam qenë unë ministre, po e theksoj, nuk është bërë pranim-dorëzim i projektit, thjesht është kërkuar qasje.

*Diskutim interaktiv në mes të kryetares së Komisionit, ministres, zëvendësministrit dhe deputetes Mirlinda Tishuka-j Sadiku.*

**Arbërie Nagavci, ministre MASHTI:** Nëse më lejoni ta vazhdoj fjalën, në momentin që e keni parë që s'është funksional, është dashur ta bëni të njëjtën gjë që e kam bërë unë, për të kërkuar auditim dhe për ta dërguar në prokurori. E përmendet disa herë z. Elezi, unë kam kërkuar të gjitha dokumentet në arkiv. Në atë kohë, ish-ministri Shyqri Bytyçi, z. Alush Istogu, u. d. i sekretarit, Mustafë Kadriu, udhëheqës i Divizionit për Standarde dhe Monitorim, z. Fatmir Elezi, zyrtar për statistika, të dy bashkë kanë kërkuar një raport për maturën digjitale, jo për gjithë projektin dhe i kanë shprehur shqetësimet e tyre. Andaj, kur kemi pasur ministra a ish-ministra që kanë qenë kompetentë dhe kanë nënshkruar, kanë pranuar kredenciale, duke u munduar për të hedhur emrin disa herë të një zyrtari, është joprofesionale.

**Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit:** Ministre e nderuar, unë as nuk kam nënshkruar, as paguar asgjë. Zyrtarin nuk po e përmendi në kontest negativ, përkundrazi ky zotëria nuk ka pranuar të nënshkruajë një raport të tillë. Për z. Elezi e kam një respekt, pikërisht pse nuk e ka nënshkruar një raport të tillë për një projekt të tillë. Postimet në rrjete sociale dhe deklaratimet për çështje publike, kanë edhe përgjegjësi, prandaj e përmenda një rast.

**Arbërie Nagavci, ministre MASHTI:** Po flitni për një postim, të cilin e kam publikuar kur e kam dërguar raportin në prokurori, të cilin e ka shpërndarë dikush. Ju lutem, për rrjete sociale e postime, flasim kur të doni në një takim tjetër. Sot po flasim për një projekt që i ka kushtuar buxhetit të shtetit 5 milionë e 600 mijë euro, i cili nuk është përdorur asnjëherë, andaj sigurisht edhe deputetët e PDK-së kanë për të thënë diçka për këtë projekt.

**Myrvete Gashi- Morina, ZKA:** Kryesuesja pyeti, pse ne e kemi bartur përgjegjësinë te MASHTI? Është e vërtetë që operatori ekonomik duhet t'i kryejë detyrat në pajtim me specifikat dhe kriteret që i ka në kontratë. Ne jemi fokusuar te ministria, sepse e kemi audituar vetëm ministrinë, andaj ministria është dashur të sigurohet, të krijojë grupet punuese, komisionin, menaxherin e projektit dhe të bëjë pranimin me një raport, në mënyrë që të paguajë operatorin në bazë të punëve dhe specifikave të kërkuara. Pagesat këtu janë kryer në heshtje, nuk ka pasur raport të pranimit dhe ministria nuk ka reaguar, andaj pagesa duhet të realizohet nga MF-ja.

**Hajdar Beqa:** Po diskutojmë për një projekt me interes të veçantë, i cili është i rëndësishëm, nëse do të funksiononte si sistem. Vërtet, është e pakuptimtë, që ne jemi në vitin 2024 dhe ende kemi problem me digjitalizim. E përgëzoj ZKA-në, që ka paraqitur një raport, ashtu siç ju ka paraqitur me letra dhe po besoj që është një prezantim i saktë. Për mua, shqetësuese është që në raport thuhet se ka pasur mungesë të informacioneve, që për mua lë për të kuptuar që nuk ka pasur të ruajtur një memorie institucionale nga një ministër në tjetrin, pavarësisht kush ka qenë dhe është e mundur që të jetë në të ardhmen në atë ministri, sepse kjo na krijon konfuzitet dhe nuk mund ta dimë pse po dështon projekti. Është mirë që është bërë një auditim dhe është mirë që lënda ka shkuar në prokurori, edhe pse është i vonuar dhe është dashur ta kemi këtë auditim, menjëherë në fillim të

mandatit. Andaj, pasi lënda është në prokurori, ne interferojmë kot. Mendoj që është dashur të bëhet një komision profesional, që mund ta konstatojë nëse ai sistem është funksional, pra çka ka ndodhur, sepse as ministrja, e as ZKA-ja, nuk mund ta dinë saktësisht çka ka ndodhur. Pra, mendoj që është dashur të ndërmerret edhe ky veprim nga ministria. Sepse, nëse operatori ekonomik e dëgjon këtë diskutim që u bë deri tash, mund ta fitojë lëndën në raport me shtetin tonë, sepse na lë fajtor për mosvënie në funksion të sistemit. Për çdo projekt ka përgjegjës. Nuk mundet një sekretar të shkojë në shpi pa e përcjellë ‘passwordin’ te sekretari tjetër. Pyetja ime është, ju i keni pranuar gjetjet, keni rreth 14 rekomandime nga ZKA. A e keni bërë planin e veprimit për zbatim të rekomandimeve dhe a keni ndonjë agjendë, që ta kemi një projekt të digjitalizimit të e-maturës, pavarësisht çka ndodh me këtë projekt?

**Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit:** Në fakt, ky s’ ishte dashur me qenë debat mes meje dhe ministres Nagavci, për shkak se është një projekt, por pasi që ministrja më ka mua përballë, po e shfrytëzon rastin, sepse nuk e ka përballë as Ramë Bujën e as Arsim Bajramin. Unë, në cilësinë e ministres, kam kërkuar për të pasur qasje në një sistem, për të cilin janë paguar 5.6 milionë. Andaj, unë i bëj thirrje prokurorisë, që ta zbardhë sa më shpejt rastin dhe kushdo që ka qenë përgjegjës, me qenë prapa grilave. Asgjë të fshehtë këtu nuk kam.

**Mirlinda Tishukaj- Sadiku:** Ky rast është shumë skandaloz. Po ashtu, ende nuk kemi emër dhe mbiemër të akuzuar. E kemi marrë një produkt që nuk funksionon dhe janë paguar 5.6 milionë euro. Marrëveshje e aprovuar nga deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe sot, fëmijët tanë nuk kanë qasje as në “e-learning” as në “e-matura”.

**Hajdar Beqa:** Askush nuk po e konteston kohën e inicimit të këtij projekti. Ka qenë dhe është projekt i domosdoshëm. Andaj, nëse është lëshim i procedurave, atëherë le të mbahen para përgjegjësisë përgjegjësit. Por, unë nuk besoj që ky projekt është si për të blerë një veturë dhe të thuhet merre, por nuk po ndez vetura. Pra, duhet parë a është defekti te vetura apo te ne që nuk po dimë ta vozisim veturën. Askush s’po tenton të fshehtë asgjë.

**Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit:** Për softuerin “e-matura”, është menduar për të pasur një qendër, në mënyrë që provimi i maturës të mbahet në kompjuter. Ku është ndërtesa, ku janë kompjuterët? Është dashur të përcillet ky projekt dhe nuk është përcjellë, as prej ministrave që e kanë iniciuar, e as nga të tjerët. Andaj, po them që kushtet nuk kanë qenë të pjekura.

**Myrvete Gashi- Morina, ZKA:** Gjatë procesit të auditimit, ne nuk kemi pasur qasje për të hyrë në sistem. Sikur t’i kishim pasur kredencialet për t’u qasur në sistem, e kishim verifikuar a është funksional, a e ka mbërri qëllimin.

**Rashit Qalaj:** Ky raport e konstaton gjendjen dhe ka një përmbajtje të keqe dhe e kemi parë që është me lëshime katastrofale, sipas auditimit. Pavarësisht detajeve, për mua është brengosëse se si mund të funksionojë një ministri, pa administrim të mirëfilltë të dokumenteve. Jemi njerëz se dikush largohet, dikush vdes, andaj brengë e imja është mungesa e dokumenteve. Çka mund të bëjë një prokuror në mungesë të dokumenteve? Emrat e përgjegjës janë të rëndësishëm për



prokurorinë, por nuk janë për ne. Për ne, e rëndësishme është mungesa e dokumenteve në një ministri. Andaj, nuk më intereson fare kush është dhe i cilit subjekt është. Po ashtu, pavarësisht shumës a janë 20 euro, apo 5 milionë, keqpërdorimi duhet të hetohet. Por, unë mendoj se duhet dalluar çështja e pajisjeve nga çështja e sistemeve. Sistemi, për shkak se nuk është shtrirë në nivel të Kosovës, normalisht se është jofunksional. Por, a mund të konstatojmë që pajisjet nuk janë funksionale? Nuk mund ta fajësojmë operatorin ekonomik në momentin që e merr çelësin burimor, sepse nga ai moment, operatori ekonomik nuk është jashtë procesit. Andaj, nëse është hyrë njëherë në atë sistem, është konstatuar se sistemi ekziston. Si përfundim, a kemi ne ndonjë mundësi, që këtë sistem ta vëmë në funksion, duke e anashkaluar pjesën e hetuesisë, duke u bazuar në strategjinë për arsimin që e përmendët. Sepse i gjithë qëllimi jonë është për të bërë arsimin sa më mirë dhe më efikas. Ajo që nuk po mundem ta kuptoj, që pavarësisht këtyre hapave që janë bërë gabim, si të lihet jashtë përgjegjësisë operatorit ekonomik, vendor dhe ndërkombëtar? Andaj, e ftoj prokurorinë, ta hetoj më shpejt rastin, sepse neve na nevojitet për ta pasur emrin e personit përgjegjës.

**Mirlinda Tishukaj Sadiku:** Gjatë ndërhyrjes time te fjala e Rashitit, tha je e prirë për të bërë konstatime, andaj për hirë të opinionit, po flasim për një produkt që ka kushtuar 5.6 milion e që nuk është në funksion të nxënësve të Republikës së Kosovës. Andaj e kam kërkuar ta kemi në shqyrtim këtë raport, sepse s'kam besuar që në Kosovën tonë të dashur, është votuar një marrëveshje nga deputetët, ka kaluar në qeveri, ka pasur zyre ligjore dhe me ardh në këtë stad ku jemi, kjo s'do koment. Andaj nuk kam prirje me konstatuar asnjëherë ndonjë gjë. Por në këtë rast ZKA-ja, ka thënë, mungon dokumenti bazë, kontrata, mungojnë specifikat teknike, ka mungesë të qasjes në sistem dhe pajisje, mungon dokumenti i protokolluar i dorëzimit të kredencialeve të qasjes në sistem, atëherë çfarë konstatime mund të bëjmë. Andaj për mu ky është një nga raportet më skandaloze, një keqpërdorim i saktë i taksave të qytetarëve, dyshimi është i bazuar në të dhënat që na i ka ofrua ZKA-ja. Ndërsa, sa i përket strategjisë, sa e kam përcjell unë, ajo është e miratuar, apo jo ministre? Po ashtu, kam pa që keni filluar rekrutimin e zyrtarëve të IT-ve nëpër shkolla, pra ku gjendemi në këtë mes, pavarësisht nga e kaluara. ZKA-ja e ka treguar qartë me rekomandime, se ku nuk duhet të gabojmë në të ardhmen që mos të vijmë në një pozicion të tillë. Këto janë konstatimet e mija, duke u bazuar në raport. Unë në asnjë raport, nuk i jap të drejtë vetes me thënë ky është hajn, ai është hajn.

**Rashit Qalaj:** Ju lutem, asnjë ministër, nuk i ruan dokumentacionet. Por brenda ministrive ka struktura dhe në periudha kohore ata persona dihen me emra kush kanë qenë përgjegjës.

**Arbërie Nagavci, ministre MASHTI:** Gjithë e dimë se ka zyra në institucione ku arkivohen e ruhen dokumentet. Kur ne i kemi kërkuar të dhënat, na janë ofrua 2 ose 3 portofolio, me disa lista të pjesëmarrësve të trajnimeve me disa veprime që janë bërë për njërin komponent të projektit. Kur kanë filluar punën auditorët, i kanë kërkuar zyrtarisht dhe në momentin që nuk i kanë siguruar dokumentet, më janë drejtuar edhe mua. Unë kam kërkuar nga sekretarja që gjitha departamentet që kanë materiale t'i grumbullojnë. Po ashtu, kemi kërkuar edhe nga arkiva dhe krejt çka kemi pasur i kemi dorëzuar te auditorët, MASHTI, nuk ka pas asnjëherë dhe ende nuk ka departament

për digjitalizim. Në planin strategjik ne e kemi parapa komponentin e digjitalizimit të sistemit të arsimit. Kemi finalizua organogramin brenda ministrisë dhe kemi parapa krijimin e Departamentit të digjitalizimit me departamentet përkatëse. Andaj, me aq sa ne kemi të dhëna, nuk është se dikush i ka larguar ato të dhëna edhe pse nuk e përjashtoj si mundësi. Është e pakontestueshme se kur është iniciua ky projekt, nuk ka pasur asnjë analizë paraprake. Andaj mënyra si është bërë ky projekt unë nuk e di. Ne nuk kemi hy në atë sistem, se nuk kemi qasje, njësoj na është thënë edhe nga ASHI-ja, andaj shpresoj që prokuroria ta shqyrtojë me prioritet këtë rast, po ashtu edhe rastet tjera ku mbi 13 lëndë unë personalisht i kam dërgua në prokurori dhe në hetuesi.

**Hajdar Beqa:** Gjatë diskutimeve ju thash që ka ekzistua një pasvord ne emër të ish- sekretarit z. Bërdynaj. A keni insistua ju me hy me pa a funksionon pajisja.

**Arbërie Nagavci, ministre MASHTI:** Ne kur e kemi pa se është e paqasshme, kemi kërkuar në ASHI dhe e kemi pa që është e paqasshme. Z. Bërdynaj kur e kam marrë detyrën, ka thënë që unë nuk di asgjë në lidhje me këtë projekt dhe nuk ka qasje, e as të dhëna për këtë projekt.

**Hajdar Beqa:** z. Agim Bërdynaj nuk e ka dorëzua passwordin. Po ashtu, ndonjë ekspert i ministrisë apo i jashtëm, a e ka vërtetua që pajisjet nuk funksionojnë, apo vetëm u thënë Agimi e ka passwordin s'ka qasje dhe po e lëmë këtu. Sepse nëse ka shkelje procedurale s'mund të themi që nuk funksionojnë pajisjet.

**Arbërie Nagavci:** Edhe një herë, kur e kam marrë detyrën, më është thënë që sistemi nuk është funksional dhe askush nuk ka pasur qasje. Zyrtarët e përfshirë nuk kanë pasur njohuri të mjaftueshme. Në raportin që kemi pranua kanë qenë disa faza të pilotimit, ku asnjë nga këto faza nuk janë kryer. Ky raport është dorëzua te ish-ministri Shyqri Bytyçi.

**Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit:** Mund të supozohet që komplet sistemi është funksional. Por në momentin që ke hy në obligime 5.6 milion, dhe ai sistem nuk ka pasur mundësi me u funksionalizua, asaj po i referohemi si jofunksionale.

**Fatmir Eleszi:** Projekti ka fillua në kohën kur ne kemi pas një projekt me Bankën Botërore, me bërë një hap në digjitalizim. Pastaj ka ardhur një projekt shumë i madh, siç e thatë edhe ju si një kulm pa u mbarua as themeli, as muret. Auditimin e kemi kërkuar për këto arsye, që ta shohim se ku jemi dhe çka mund të realizohet, çka jo. Në kohën kur ministër ka qenë Shyqri Bytyçi, është bërë raporti i pranimit, të cilin unë nuk e kam nënshkruar sepse në atë raport nuk shkruan se çka funksionon e çka jo. Por sugjerohet me marrë një projekt tjetër, pra nisma e katit të parë dhe më pas të punohet themeli. Nga 5 anëtarë, 2 nuk e kemi nënshkruar. Te auditorët, mu vetëm më ka pengua pse nuk janë marrë pak më shumë me raportin e pranimit.

**Hajdar Beqa:** Anëtarët e atij komisioni, a kanë qenë kompetentë për këtë projekt, apo jo?

**Fatmir Elezi:** Besoj që kanë qenë sepse, sepse janë profesorë të Fakultetit teknik dhe IT-së nëpër institucione. Unë jam marrë më shumë me e-maturën, sa i përket e-edukimit, nuk kam qenë pjesë,

por e di që e kanë marrë 2 zëvendësministrat në atë kohë dhe kanë tentua me funksionalizu, për tu mbajtur mësimi online. Por, unë prapë mendoj se nuk ka një raport të pranimit për këtë raport. Përveç kësaj, nuk është përcjell puna sepse edhe 2 vjet e kanë pasur mirëmbajtjen dhe asnjë interesim nuk e kemi pasur prej operatorit se çka po ndodh. Interesimi i tyre ka qenë si me marr projektin e dytë. E-shkollori ka mund të përdoret në disa shkolla, ku ka pasur pajisje, por nuk ka pasur një vazhdimësi sepse nuk ka pasur pranim të këtij projekti, sepse është një faqe ku nuk sqarohet çka funksionon e çka jo.

**Arbërie Nagavci:** Nuk e përmenda një detaj, që para këtij projekti para vitit 2014, kanë qenë edhe dy projekte të tjera, ku janë investua miliona euro për digjitalizim. Isidielli për trajnimin e mësimdhënësve, që ka pasur diku 5 milion euro dhe para tij një sistem për ditarët elektronik, edhe ai projekt milionësh. Kur kemi kërkuar në ASHI e kemi pa një projekt të tillë që është pilotua në 3 komuna, e ndër to ka qenë edhe Komuna e Kamenicës.

**Hykmete Bajrami, kryetare e komisionit:** Edhe një projekt i ngjashëm ministre e ka bërë Komuna e Prishtinës e-ditari, në kohën e Shpend Ahmetit, e keni bë ju si komunë atëherë.

**Arbërie Nagavci, ministre MASHTI:** Sa unë kam qenë Drejtoreshë, është bërë pajisja me disa televizorë të mençur në mënyrë që nëse mësimdhënësit fillojnë trajnimet, në mënyrë që të mos mbetet pa implementim projekti, e pastaj a ka vazhdua me projekte tjera pas meje nuk e di, sepse ka pasur disa projekte, për digjitalizim të shkollave.

**Hykmete Bajrami, kryetare e komisionit:** Druaj që edhe një projekt i tillë është në vazhdimësi. Fjala është për projektin Gjuha shqipe dhe kompjuteri. Pra, është projekt që ka fillua shumë më herët dhe ka informacione që është duke u vazhdua të paguhen këstet, e në fakt nuk e kemi pa ndonjë platformë që është duke u përdorë ende, nëse mund të na informoni më vonë edhe në lidhje me këtë.

**Albana Bytyqi:** Ajo që më bëri përshtypje është se auditorit në vazhdimësi e thanë që nuk kanë pasur qasje në sistem. Ligji ua lejon me pas qasje të pakufizuar gjatë auditimit. A nuk keni pasur qasje, apo s'keni gjet dokumente të mjaftueshme. Cila është arsyeja që nuk keni pasur qasje. E kam një pyetje për ministren jashtë raportit. Jemi në muajin korrik dhe mendoj që është dashur qysh në fillim të vitit të bëhet me dije forma e subvencionimit me tekste shkollore.

**Arta Bajralija:** Kisha kërkuar të përqendrohemi te raporti, sepse këto pyetje mund ti parashtroni si pyetje parlamentare.

**Albana Bytyqi:** Pasi e patëm ministren këtu e bëra këtë pyetje. A keni me ju kthye formës së vjetër të subvencionimit apo formës së re, sepse është bërë një kaos, prandaj edhe në Kuvend është krijuar edhe komision hetimor për këtë rast.

**Arbërie Nagavci, ministre MASHTI:** Është konstatim i juaji që është bërë kaos. Komisionin hetimor e kam mbështet plotësisht. Si për projektin që po flasim, si për shumë projekte tjera, ndër

vite ka pasur probleme tepër të mëdha, të cilat ne është dashtë me i adresua. Andaj shpresoj që prokuroria t'i shqyrtojë të gjitha lëndët që ne i kemi dërgua, përfshi edhe furnizimin me tekste shkollore.

**Albana Bytyqi:** Unë ta bëra pyetjen, ti mundesh me u përgjigj. Çështja tjetër që kam është: gjatë mandatit tuaj, çka konsideroni të arriturat e juaja, edhe sa i përket digjitalizimit. Sepse nuk e di çka mundeni me arrit ju, sepse ju jeni një ndër shkelëset e kushtetutës.

**Arbërie Nagavci, ministre MASHTI:** E nderuara deputete, që ke rastisë me qenë deputete, a ke ndonjë pyetje për temën që na keni thirrur, a e keni lexuar raportin?

**Hykmete Bajrami, kryetare e komisionit:** Ministre, të lutem, ne nuk kemi rastisë asnjë me qenë deputet, por jemi kandiduar dhe jemi zgjedh me votat e qytetarëve.

**Albana Bytyqi:** Unë ti bëra pyetjet dhe ti mundesh mu përgjigj. Se pse jeni ju ndër ministrat më të dështuar dhe që e keni shkelur kushtetutën kjo dihet. Andaj MASHTI, nuk mund të ketë një rezultat më të mirë, përderisa ju jeni në krye të kësaj ministrie.

**Arbërie Nagavci, ministre MASHTI:** Sa më shumë që ju vazhdoni me konstatime dhe cilësime të tilla, unë jam e bindur që jam në rrugë të drejt dhe do të vazhdoj edhe më suksesshëm se kaq.

**Albana Bytyqi:** Po shihet sukcesi, po afrohet shtatori dhe ju ende nuk e dini se si do të bëhet subvencionimi me tekstet shkollore.

**Hykmete Bajrami, kryetare e komisionit:** Të lutem ministre a keni përgjigje si do të bëhet subvencionimi me tekste shkollore?

**Arbërie Nagavci, ministre MASHTI:** E para nuk ka pasur asnjë situatë skandaloze siç u tha këtu. Përgjigja e ime është se të gjithë prindërit dhe të interesuarit me kohë do të njoftohen për furnizimet me tekste shkollore.

**Myrvete Gashi Morina, ZKA:** Deputetja pyeti a kemi pas kufizim të fushëveprimit apo mungesë të dokumenteve, në këtë rast i kemi pasur të dyja. Nuk ka pasur dokumente të mjaftueshme dhe nuk kemi pas kredenciale për me u fut në sistem me e pa funksionalitetin ose jo të sistemit.

**Yllëza Hoti:** E di që operatori ekonomik nuk e ka për detyrë me ju përgjigj, por a keni tentua me ti kërkoni kredencialet nga operatori ekonomik?

**Myrvete Gashi Morina, ZKA:** Jo nuk kemi tentua, sepse nuk është detyrë e jona që ta kontaktojmë operatorin ekonomik. Është detyrë e ministres, që të na i siguroj kredencialet.

**Hykmete Bajrami, kryetare e komisionit:** Për projektin Gjuha shqipe dhe kompjuteri. A kemi produkt të gatshëm, a po vazhdojnë pagesat dhe a është duke u shfrytëzua diku një produkt i tillë?

**Arbërie Nagavci, ministre MASHTI:** Siç mund ta dini ai projekt është iniciuar në qeverinë e z. Haradinaj, në atë kohë, për të cilin ne po ashtu kemi pasur pretendime të bazuara që ka keqpërdorim edhe atë projekt e ka audituar ZKA-ja dhe ka gjetur shkelje dhe të njëjtin ne e kemi dërgo në hetuesi dhe prokurori.

**Hykmete Bajrami, kryetare e komisionit:** A kanë vazhduar pagesat, gjatë mandatit tuaj?

**Arbërie Nagavci, ministre MASHTI:** Pagesat kanë vazhduar të bëhen, sepse zyrtarët ligjorë kanë thënë, pasi që lënda është në hetuesi, ne kemi obligimi kontraktuale të cilat nuk mund ti shmangim deri sa ta kemi një vendim përfundimtar.

**Hykmete Bajrami, kryetare e komisionit:** Ministre, pra do të thotë që ju për një projekt që e keni dërgua në prokurori, në të njëjtën kohë keni bërë pagesa? Sepse kur ke dyshime të bazuara, nuk detyrohesh të paguajnë, e ndërprejnë pagesën.

**Arbërie Nagavci, ministre MASHTI:** E nderuara deputete, ish- ministre e arsimit dhe ish- ministre e financave, kryetare e komisionit, e cila do të duhej t'i dinit më mirë se unë këto çështje. Ne jemi njoftuar dhe besoi që këto pagesa janë kryer edhe në kohën edhe sa ju keni qenë ministre.

**Hykmete Bajrami, kryetare e komisionit:** Jo jo nuk janë krye, pikërisht për këtë edhe po pyes.

**Arbërie Nagavci, ministre MASHTI:** Kushdo që është përgjegjës për këtë projekt dhe kurdo që dëshironi mund t'ua sjelli detajet, sepse nuk mund ti di përmendsh. Është i dorëzuar një produkt, por, dyshimet tona na kanë shty ta dërgojmë në hetuesi.

**Halil Thaqi:** Më bëri përshtypje, se për këtë rast edhe deputetja dhe ish -ministrja e asaj kohe, paska bë një lëvizje për këtë dhe ka pranuar kredencialet. Me intereson ta di pas pranimi të kredencialeve, a keni gjet ndonjë raport çka ka ndodh pas pranimi të kredencialeve. Ky projekt po shihet që nga fillimi ka qenë i destinuar të dështojë, duke pasur parasysh që s'ka pasur specifika, plan as menaxher të kontratës asgjë. Por, ZKA-ja ka thënë që përkundër gjitha këtyre, është shfrytëzua heshtja administrative dhe pagesat janë bërë. A mundeni me na tregu se cilët janë ata ministra që i kanë bërë këto pagesa, në cilën kohë?

**Arbërie Nagavci, ministre MASHTI:** Në lidhje me kredencialet, pas pranimi në vitin 2020, në ministri nuk kemi gjet ndonjë raport ose reflektim, që pas pranimi të kredencialeve a kanë qenë në shërbim apo jo. Sa i përket pagesave, pagesa e janë realizua nga viti 2014, deri vitin 2016 kemi gjet disa pagesa por nuk janë të dhëna të plota.

**Myrvete Gashi Morina, ZKA:** Datën e saktë nuk e kemi, por si informatë e përgjithshme pagesat janë krye para se të bëhet raporti final.

**Taulant Kelmendi, MSHTI:** Në 2017, e kemi një raport, po duhet ta theksoj që akoma vazhdon me u pagua kredia për këtë projekt. Ndërsa, dua të ndërlidhem me komentin e kryetares që tha që

në mandatin e saj nuk është bërë asnjë pagesë, për projektin gjuha shqipe dhe kompjuteri. Po, është bërë një pagesë në mars të vitit 2020.

**Hykmete Bajrami, kryetare e komisionit:** Me çfarë date, se në fund të marsit e kemi marrë mandatin?

**Taulant Kelmendi, MSHTI:** Ka diskrepancë kjo që thoni sepse me datë 18 mars keni pranua kredencialet.

**Hykmete Bajrami, kryetare e komisionit:** Ju e keni trashëguar sekretarin që e kam pas edhe unë, keni mundur ta thirrni dhe pyesni për këto detaje. Andaj mos e devijoj diskutimin.

**Arbërie Nagavci, ministre MASHTI:** Ne e kemi thirrur dhe e kemi kuptuar që në kohë tuaj janë pranuar kredencialet.

**Hykmete Bajrami, kryetare e komisionit:** Në rregull, po çka ka lidhje kjo aty është emri dhe mbiemri i personit. Më trego ministre, në cilat sisteme i mbani ju si ministre passwordet, unë nuk mendoj që i mbani ju sepse janë personat përgjegjës për punë të tilla. Unë të thash se ju edhe keni paguar për një projekt të tillë të ngjashëm.

**Arbërie Nagavci, ministre MASHTI:** Ju keni qenë ministre, a po na tregoni ju se çka keni ndërmarr ju për ta ndaluar projektin gjuha shqipe dhe kompjuteri.

**Hykmete Bajrami, kryetare e komisionit:** Çka kam bërë unë sa kam qenë ministre dihet komplet. Si ministre kem kërkuar kredenciale, në sistem s'jam qas unë por zëvendësministrat Xhavit Rexha dhe Jusuf Thaqi.

**Arbërie Nagavci, ministre MASHTI:** Kjo që po e thoni është deklaratë publike.

**Hykmete Bajrami, kryetare e komisionit:** Ju lutem a ka mundësi të flasim me radhë sepse kështu nuk mund të kuptohemi.

**Arbërie Nagavci, ministre MASHTI:** Përderisa më thua mu a e ke pyet Agim Bërdynen, duhet me pyet vetën më së pari a e ke pyet ti, a po hapen këto kredenciale, a po funksionon sistemi, nëse të ka thënë po, kjo nënkupton që sistemi ka qenë funksional. Andaj nëse ka qenë jofunksional është dashur t'i ndërmerrni veprimet e nevojshme.

**Hykmete Bajrami, kryetare e komisionit:** Edhe pse s'jam e obliguar me u përgjigj, po të jap përgjigje. Kam kërkuar me pas qasje, sepse është thënë e keni sistemin e gatshëm për mësim online, po flasim për kohën e pandemisë. Zëvendësministrat dhe ekipi kanë hy dhe kanë pa që ka një sistem të zbrazët dhe nga dita e parë kemi filluar xhirimin e e-mësimeve. Në kohën e pandemisë kemi punuar 18 vetë në krejt ministrinë po ashtu, gjitha institucionet kanë qenë me staf të limituar. Sa i përket projektit gjuha shqipe dhe kompjuteri, ekziston dokumenti ku në atë kohë, unë i kam bërë ZKA-së, për tu audituar projekti. Ndërsa për të dorëzuar raste në prokurori në atë kohë nuk ka pasur mundësi. Ndërsa projekti që po flasim e që po devijohet, problem kryesor është mënyra

qysh është iniciua projekti. Po ashtu, ju e dini që kur keni qenë në drejtori të arsimit në komunë, në DKA ka të dhëna që janë mbajtur disa trajnime, me siguri për një kohë ata kanë pasur qasje. Çka ka ndodh mbetet nga ekspertet dhe zyrtarët përgjegjës që ta analizojnë si rast. Andaj ka një dallim të madh mes meje dhe teje. Sepse ju thoni që projektin gjuha shqipe dhe kompjuteri ju vet e keni dërgua në prokurori dhe mandej keni vazhdua me pagesa, andaj unë nuk mendoj që për një projekt që dërgohet në prokurori, duhet me u vazhdua pagesat.

**Arbërie Nagavci, ministre MASHTI:** E konsideroj të rëndësishme informatën, sepse nuk e kemi pasur që ju keni hy në sistem dhe keni shikuar dhe e keni parë që s'ka përmbajtje. Kjo është një e dhënë e rëndësishme, sepse po flasim për vitin 2020.

**Hykmete Bajrami, kryetare e komisionit:** Nuk ka pasur përmbajtje, mos i devijoni....

**Taulant Kelmendi, MSHTI:** Deri tash jemi duke folur që sistemi nuk funksionon, tash nga ish-ministrja, thotë që kanë hy, kjo është informatë për gjithë....

**Hykmete Bajrami, kryetare e komisionit:** Ju lutem mos i devijoni diskutimin le të jetë informatë për këdo.....

*Mbledhja e komisionit ka përfunduar me diskutim shumëpalësh dhe pjesa 5 minutëshe e fundit nuk ka mundur të nxirret si diskutim individual.*

Mbledhja përfundoi në orën 14:00

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit

**Hykmete Bajrami,**

---

**Kryetare e Komisionit**

